

Prezantimi i raportit përfundimtar të auditimit të përbashkët të performancës me temë: “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”

Më datë 17 korrik 2024, në Shkup u organizua takimi rajonal i promovimit të raportit përfundimtar të auditimit të përbashkët të performancës me temë: **“Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”**. Ky auditim u realizuar në bashkëpunim me Entit Shtetëror të Revizionit të Maqedonisë së Veriut, Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, KLSH dhe UN Women.

Takimi u përshëndet nga z. Maksim Acevski, Kryerevizor Shtetëror i Entit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut i cili foli për rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe raportin e auditimit si një përpjekje e përbashkët për arritjen e barazisë gjinore.

Në fjalën e saj znj. Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës vuri theksin në rolin thelbësor që ne si auditues luajmë në mbajtjen e angazhimeve të qeverive ndaj barazisë gjinore dhe si ne mund të identifikojmë mundësitë e humbura për fuqizimin e grave dhe grupeve të marginalizuara”.



Në fjalën e tij z. Alfred Zylfi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës të KLSH u përqendrua në vlerësimin e bashkëpunimit të SAI-eve tona, si mundësi diskutimi e një çështje kaq të rëndësishme dhe të ndjeshme për shoqërinë tonë si dhe të kontribuojnë sadopak në nxitjen e institucioneve publike, organizatave joqeveritare, rritjen e vëmendjes qytetare, në vlerësimin e peshës së dobishme, të problematikave të paraqitura nëpërmjet auditimit të performancës me temë **“Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”** i realizuar, në bashkëpunim me Entin Shtetëror të Revizionit të Maqedonisë së Veriut, Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës dhe UN Women.

Takimi u përshëndet nga znj. Elisa Fernandez Saenz, Zëvendës Drejtoreshë Rajonale e UN Women për Evropën dhe Azinë Qendrore, z. Lusien Aegerter, Zëvendës Ambasador i Zvicrës në Maqedoninë e Veriut dhe z. Mikael Aterhog, Udhëheqës për bashkëpunim zhvillimor në Ambasadën e Suedisë në Maqedoninë e Veriut të cilët vunë theksin në rolin që luajnë Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-t) në auditimin dhe vlerësimin e shpenzimeve qeveritare për të siguruar që alokimet buxhetore janë të përgjegjshme ndaj gjinisë, duke reduktuar në mënyrë efektive pabarazitë gjinore si dhe funksionit të tyre mbikëqyrës, në ofrimin e këshillave për politikën, në integrimin e parimeve të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinnor (BGJP) në proceset buxhetore si dhe në ngritjen e kapaciteteve në të gjitha aspektet e planifikimit, ekzekutimit dhe vlerësimit të buxhetit.

Më tej takimi vijoi me prezantimet e rezultateve të auditimit nga grupet e auditimit të Entit Shtetëror të Revizionit të Maqedonisë së Veriut, Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës dhe KLSH-së. Në përfundim, pjesëmarrësit zhvilluan pyetje dhe vlerësuan maksimalisht bashkëpunimin e deritanishëm.

KLSH në këtë takim u përfaqësua nga z. Alfred Zylfi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës, znj. Ermira Hoxha, Drejtore e Burimeve Njerëzore e cila prezantoi auditimin si dhe znj. Arminda Bushi e znj. Jorida Zhegu audituese dhe anëtare të grupit të auditimit.